



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËBIMEVE ARSIMORE

Nr. 5451 Prot.

Tiranë, më 26.12.2023

URDHËR

Nr. 188, Datë 26/12/2023

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN
SHTETËRORE PROFESIONALE 2024**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit e Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2024, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALLIU



Referenca Urdhri nr. 661, datë 01.12.2023, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”	Periudha/Data
Kreu II Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të maturës	
Neni 7, pika 15	Dërgon në QSHA, brenda datës 18 mars 2024, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja “m”	Plotëson brenda datës 29 prill 2024, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturant/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja “n”	Plotëson në periudhën 3 – 14 qershor 2024, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja “p”	Në periudhën 17 – 21 qershor 2024 përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
Kreu IV Aplikimi për provimet e maturës	
Neni 13, pika 2	Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania në periudhën 22 janar – 13 shkurt 2024, dhe më pas, në portalin “e-Matura”, në periudhën 23 janar – 14 shkurt 2024. Aplikimi në sistemin “e-Matura”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.